



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/206 Nr. i faq./Br.str./No.pg 63

Data/Datum/Date 28/03/2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8, nenit 16 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3948/24 i datës 08.03.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për organizatat e shoqërisë civile dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Bërnjak, në vendin e quajtur grlo-vrnjaqka, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510006-00301-3, në sipërfaqe prej 486m<sup>2</sup> (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1500m<sup>2</sup> (njëmijë e pesëqind metra katror), duke përfshirë edhe objektin, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e aktiviteteve të shoqërisë civile me qëllim të promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 5 (pesë) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale duke përfshirë edhe objektin, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi do të jetë 1€ (një euro) në muaj.
7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien

e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.206/24**  
**Me datë:28.03.2024**

